



VENDIM

Nr. 9, Datë 27.01.2016

MBI
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP
MBI VERIFIKIMIN E MATESAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE,
DHE VULOSJEN E TYRE.

Në mbështetje të neneve 16 dhe 77 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike, Ligjit Nr.9875, datë 14/02/2008 “Për Metrologjinë” i ndryshuar dhe Kodit të Matjes i ndryshuar, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.01.2016, mbasi shqyrtoi draftin e kontratës Tip mbi verifikimin e matësave të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre, dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë teknike të ERE,

Konstatohet se :

- Shoqëria HTT me shkresën nr. 217 Prot., datë 12.01.2016, ka depozituar në ERE propozimin për miratimin e kontratës tip mbi verifikimin e matësave të energjisë dhe vulosjen e tyre.
- ERE në bazë të nenit 77 pika 10 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ka detyrimin të miratojë kontratën tip mbi verifikimin e matësave të energjisë dhe vulosjen e tyre.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendos:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kontratës Tip mbi verifikimin e matësave të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimmarrjen e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

